

Raporti vjetor i organeve të administratës shtetërore për avancimin e gjendjes së mundësive të barabarta të grave dhe burrave

1. INFORMACIONET BAZË

Organi i administratës shtetërore (emri)	Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Përpiluar (emri, mbiemri dhe funksioni)	Merzije Gashi Sulejmani, udhëheqëse e njësisë për planifikim strategjik, krijim politikash dhe ndjekje, analiza – koordinatorë e mundësive të barabarta të grave dhe burrave Borjana Janakieva Zaeva, këshilltare për monitorimin dhe evaluimin e nxënësve dhe mësimdhënësve – zëvendëskoordinatorë e mundësive të barabarta të grave dhe burrave.
Periudha e raportimit	1.1.2023-31.12.2023
Data e paraqitjes së raportit	14.3.2024

Personi përgjegjës që miraton raportin dhe verifikon besueshmërinë e tij

Nr. 04-487/2

Data: 19.3.2024

Emri dhe mbiemri: Abdulfeta Fetai – u.d. drejtor i Byrosë së Zhvillimit të Arsimit

Nënshkrimi

(Personi përgjegjës i organit të administratës shtetërore)

Data e pranimit të raportit në Ministrinë për Punë dhe Politikë Sociale

Emri dhe mbiemri (udhëheqës i Sektorit për mundësi të barabarta)

Nënshkrimi

2. ZBATIMI SIPAS LIGJIT PËR MUNDËSI TË BARABARTA TË GRAVE DHE BURRAVE

2.1. Masat themelore dhe të veçanta të ndërmarra sipas nenit 5, 6 dhe 7 nga LMB (rrethoni)

A) Pozitive

B) Inkurajuese

C) Programore

2.2 Matja e suksesit të masës (rendisni informacione të shkurta – tregues cila është rezultati me zbatimin e kësaj mase):

- Janë hartuar programet e reja mësimore, bazuar në parimet e ndjeshmërinë/barazinë gjinore, gjithëpërfshirjen, interkulturën në lëndët mësimore nga klasa 6 dhe 7, sipas planit të mësimin për arsimin fillor të Konceptit për arsimin fillor të vitit 2021;
- Janë trajnuar mësuesit për programet e reja mësimore;
- Janë analizuar libra shkollor, literaturë profesionale dhe revistat për arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm nga aspekti i ndjeshmërisë gjinore;
- Janë miratuar materialet e mësimin dhe doracakët për klasat 3, 5 dhe 6, duke implementuar kërkesat që janë drejtuar ndaj ngritjes së vetëdijesimit për ndjeshmërinë/barazinë gjinore, gjithëpërfshirjen dhe interkulturën;
- Janë trajnuar mësuesit nga programi i akredituar në temën "Barazia gjinore dhe ndjeshmëria gjinore në shkollë" për mësuesit e shkollave fillore;
- Popullsia e sensibilizuar e mësuesve dhe prindërve për AGjS.

2.3. A keni parashikuar treguesit/ indikatorët e matjes së suksesit dhe zhvillimit? (Ju lutem rendisni vetëm indikatorët output¹)

- Programet mësimore të miratuara për të gjitha lëndët mësimore në klasat 6 dhe 7;
- Numri i mësuesve të trajnuar që realizojnë mësim në klasat 4 dhe 6 në arsimin fillor;
- Numri i mësuesve të trajnuar nga shkollat fillore në temën "Barazia gjinore dhe ndjeshmëria gjinore në shkollë" për vitin 2023;
- Numri i mendimeve profesionale për dorëshkrimet e librave, literaturën profesionale dhe revistat për fëmijët për arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm;
- Numri i mësuesve dhe prindërve të sensibilizuar për AGjS-së në nivelin komunal.

2.4. Nëse keni dokumente dhe bashkëngjitje që flasin për progresin, bashkëngjitni ato në raport:

www.bro.gov.mk

3. INICIATIVAT E NDËRMARRA

3.1. Iniciativat e ndërmarra për inkorporimin e parimit të mundësive të barabarta për gra dhe burra në planin strategjik dhe buxhetin e organit të administratës shtetërore (OASH), sipas nenit 11 të LMB:

Byroja e Zhvillimit të Arsimit, si një nga organet që krijon dhe zbaton politikat arsimore në vend, inkorporon me kujdes parimin e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat në të gjitha kompetencat që ka dhe detyrat që kryen.

- Një nga iniciativat në Byronë e Zhvillimit të Arsimit, e cila vazhdon të realizohet edhe në vitin 2023, është zbatimi i kritereve për mundësi të barabarta për gratë dhe burrat në përputhje me Ligjin për mundësi të barabarta të grave

¹ *Output treguesit* masin sasinë e mallrave ose shërbimeve të fituara nga zbatimi i aktiviteteve të programeve të veçanta, ose numrin e grave dhe burrave të mbuluar nga programet e veçanta. Shembull i output indikatorit është numri i burrave/grave të mbuluar nga programet shëndetësore, numri i grave të mbuluara nga programi i subvencionimit bujqësor, numri i grave nga grupi i synuar 24-49 vjeç të mbuluara nga programi i masave aktive të punësimit, etj. Marrë nga *Udhëzimet për përgatitjen propozimit për llogaritjen e buxhetit*, Ministria e Financave, http://www.mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/OP_2012.pdf

dhe burrave (barazia gjinore) gjatë punësimeve dhe avancimeve në Byro.

- Përfshirja e një numri më të madh të punonjësve të institucionit në trajnime apo aktivitete të tjera që mbështesin tema që kanë të bëjnë me barazinë gjinore me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për barazinë.

3.2. Matja e suksesit të iniciativës (rendisni informacione të shkurtra-tregues të rezultatit të zbatimit të kësaj nisme):

Punësimi i tre burrave gjatë vitit 2023 mund të cilësohet si një nismë e suksesshme. E theksojmë këtë sepse në Byronë për Zhvillimin e Arsimit ka rreth 50% më pak burra të punësuar sesa gra të punësuar, gjë që është evidente në Shtojcën 1.

3.3. A keni paraparë tregues/indikatorë për matjen e suksesit dhe progresit (shembull për tregues)

Numri i të punësuarve të rinj sipas parimit të mundësive të barabarta për gratë dhe burrat;

Numri i punonjësve të BZhA-së të përfshirë në trajnime dhe aktivitete të tjera lidhur me barazinë gjinore.

3.4. Nëse keni dokumente dhe bashkëngjitje që flasin për progresin, bashkëngjitni ato në raport:

/ Shtojca 1.

4. BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATA TJERA DHE BAZA E TË DHËNAVE

4.1. Rendisni aktivitetet për promovimin e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat që institucioni juaj ka realizuar në bashkëpunim me partnerët socialë dhe organizatat joqeveritare aktive në fushën e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat.

Në bashkëpunim me HERA janë mbajtur tri takime me mësimdhënës dhe prindër nga shkollat fillore nga tri komuna, përkatësisht; Kavadar, Qendër - Shkup, Gostivar për prezantimin e programit për lëndën e lirë zgjedhore Arsimi gjithëpërfshirës seksual, me qëllim të sensibilizimit të popullatës së mësimdhënësve dhe prindërve për përfitimet e realizimit të programit për AGjS me nxënës të klasës së nëntë në arsimin fillor.

4.2. A është baza e të dhënave në dispozicion të OASH-së e ndarë sipas gjinisë?

a) bazën e të dhënave në lidhje me burimet njerëzore

*** bashkëngjitni një dokument me një pasqyrë të burimeve njerëzore të ndarë sipas gjinisë (numri i përgjithshëm i punonjësve, sipas titullit)**

Baza e të dhënave për punonjësit e Byrosë së Zhvillimit të Arsimit, që ju paraqesim në Shtojcën 1, është e ndarë sipas gjinisë, nivelit të arsimimit dhe llojit të pozicionit të punës.

b) bazë të dhënash që i referohet pjesës së programit (fushëveprimi i përdoruesve sipas gjinisë së programeve të caktuara, shërbimeve, masave, etj.) /

*** bashkëngjitni dokument me një përshkrim të shkurtër të programit/shërbimit dhe të dhënave të ndara sipas gjinisë për përdoruesit e synuar, grupet e synuara dhe të dhënat e ndara sipas gjinisë për përdoruesit e mbuluar, grupet e synuara, etj./**

5. DETYRIMET

5.1. Tregoni detyrimet tuaja sipas Strategjisë për Barazi Gjinore (SBGj), Planit Kombëtar të Veprimit dhe Planit Operacional për vitin raportues.

Përshkruani nga:

a) Rezultatet e arritura

- **Popullatë e sensibilizuar e mësuesve dhe prindërve** nga tri komuna për përfitimet e zbatimit të programit të AGJS me nxënësit e klasës së 9-të në shkollën fillore;
- Hartimi dhe miratimi i **programeve mësimore të reja** për arsimin fillor për klasat 6 dhe 7 në përputhje me Konceptin për Arsimin Fillor (2021) i cili promovon barazinë gjinore, gjithëpërfshirjen dhe multikulturalizmin. Në klasën e VI-të nga viti shkollor 2023/2024 mësimi zhvillohet sipas programeve të reja mësimore;
- **Materialet dhe doracakët mësimore** të miratuara për klasat e III, V dhe VI, sipas programeve të reja për vitin 2023/2024.
- **Mendimet profesionale të dhëna për dorëshkrimet e teksteve shkollore** për arsimin fillor me kërkesë të Shërbimit Pedagogjik-MASH.
- Në kuadër të programit të akredituar është realizuar **trajnimi me temën “Barazia gjinore dhe ndjeshmëria gjinore në shkollë”,** përmes të cilit janë trajnuar mësuesit e arsimit fillor.

b) Aktivitetet e realizuara

- Në bashkëpunim me HERA janë mbajtur tri takime me mësimdhënës dhe prindër nga shkollat fillore nga tri komuna: Kavadar, Qendër-Shkup dhe Gostivar për prezantimin e programit për lëndën e lirë zgjedhore AGJS-së;
- Janë zhvilluar programe të reja për klasat e 6-ta dhe të 7-ta që promovojnë barazinë gjinore, multikulturalizmin dhe gjithëpërfshirjen;
- Janë miratuar materialet mësimore dhe manualet për klasat 3, 5 dhe 6-të, që janë në përputhje me programet e reja që promovojnë barazinë gjinore;
- Janë përgatitur mendime profesionale për dorëshkrimet e teksteve shkollore, revista, fletore pune dhe literaturë profesionale për mësuesit.
- Mësuesit e arsimit fillor janë trajnuar me programin e akredituar të trajnimit me temë: “Barazia gjinore dhe ndjeshmëria gjinore në shkollë”

c) Indikatorët e matjes së suksesit

- **1052** mësimdhënës dhe prindër të sensibilizuar nga shkollat fillore nga tri komuna;
- **38** programe të reja mësimore;
- **20** materiale mësimore dhe manuale;
- **12** mendime profesionale për tekstet e arsimit fillor
- **13** mësues të trajnuar me temën “Barazia gjinore dhe ndjeshmëria gjinore në shkollë”

ç) Fondet e shpenzuara për aktivitete të realizuara në fushën e barazisë gjinore dhe burimi i fondeve /

5.2. A janë përcaktuar kompetencat dhe detyrat e koordinitorit dhe zëvendëskoordinatorit konkretisht në aktin për sistemimin e vendeve të punës në organet e administratës shtetërore?

Në Byronë e Zhvillimit të Arsimit, kompetencat e koordinitorit dhe zëvendëskoordinatorit NUK përcaktohen në mënyrë specifike në aktin e sistemimit të vendeve të punës.

5.3. Çfarë trajnimesh kanë ndjekur koordinatori dhe zëvendëskoordinatori gjatë periudhës raportuese?

A u paraqitën në trajnimet si:

a) dëgjues

Gjatë vitit 2023, koordinatori dhe zëvendëskoordinatori kanë ndjekur këto trajnime: Trajnime gjenerike për nëpunës administrativë (MSHIA); Konferenca "Sfidat me të cilat përballen gratë dhe vajzat në rajon në rrugën drejt BE-së" - MPPS, Konferenca për Shëndetin Mendor - UNICEF dhe Zëvendës Koordinatori dhe Trajnim për: Njohuri mediatike; koordinatori: , Trajnim mbi konceptet bazë gjinore - WE global, BE për të rinjtë, punëtori „Gender transformative approach in programme interventions for implementing partners“ - UNICEF,

Në rolin e trajnuesve, koordinatori dhe zëvendës koordinatori mentoruan:

- 10 bashkëpunëtorë profesional nga arsimit fillor dhe i mesëm në proces të realizimit të trajnimeve për Programin për shëndet mendor dhe mbështetje psikosociale të bashkëpunëtorëve profesional nga shkollat tjera. Trajnues për Arsimin Gjithëpërfshirës (3 module) të ekipeve gjithëpërfshirëse nga shkollat fillore;
- dhe zëvendës koordinatori:
- trajnues për mësimdhënësit e klasës së IV për programet e reja për Konceptin e ri për arsimin fillor; më pas trajnues i trajnimeve për edukimin mediatik për mësuesit e shkollave fillore.

5.4. Brenda periudhës së plotë të kryerjes së funksionit, specifikoni cilat trajnime (specifikoni barazinë gjinore dhe kundër diskriminimin tematik, trafikimin me njerëzit, dhunën në familje, barazinë gjinore dhe mbrojtjen sociale, etj.) kanë vizituar:

a) koordinatori për mundësi të barabarta - Konferencë "Sfidat me të cilat përballen gratë dhe vajzat në rajon në rrugën drejt BE-së" – MPPS-së, workshop „Gender transformative approach in programme interventions for implementing partners“ – UNICEF-i, Trajnim mbi konceptet bazë gjinore - WE global, BE për të rinjtë.

b) zv/koordinatori për mundësi të barabarta - Konferenca "Sfidat me të cilat përballen gratë dhe vajzat në rajon në rrugën drejt BE-së" – MPPS

5.5. Si transferohen më tej njohuritë e marra në OASH-në tuaj, a keni një metodë apo sistem të vendosur të transferimit të njohurive (transferim informacioni, shkëmbim materiale, mbajtje të seancave të shkurtra për transferimin e njohurive te kolegët, etj.)

Njohuritë e fituara transferohen kryesisht duke shkëmbyer informacione dhe materiale, dhe ndonjëherë duke mbajtur seanca të shkurtra për të transferuar njohuritë te kolegët.

5.6. Sa dhe cilat iniciativa (ligje të propozuara, strategji të propozuara, informacione të propozuara për qeverinë, plane të propozuara veprimi, buxhete të propozuara, plane strategjike të propozuara) i kanë dorëzuar OASH-së koordinatori dhe zëvendëskoordinatori për mundësi të barabarta për gratë dhe burrat?

Koordinatori dhe zëvendëskoordinatori i kanë dorëzuar Byrosë së Zhvillimit të Arsimit informacion rreth aktiviteteve të planifikuara në kuadër të Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi Gjinore 2022-2024. Gjithashtu, u dha informacion për strukturat drejtuese, se bazat e të dhënave për pjesën e programit (përdoruesit e trajnimeve, shërbimeve, masave, etj.) duhet të ndahen sipas gjinisë në të ardhmen, si dhe që baza e të dhënave për burimet njerëzore të plotësohet me titullin.

5.7. Sa nga këto iniciativa kanë qenë të suksesshme?

6. SFIDAT, PRAKTIKAT E MIRA DHE MËSIMET E NXJERRA

6.1 Tregoni nëse dhe çfarë sfidash keni hasur gjatë vitit raportues dhe çfarë propozimesh keni bërë për t'i kapërcyer ato.

Mungesa e statistikave të ndara sipas gjinisë për pjesën programore, me tregues të saktë të mundësive të barabarta për gratë dhe burrat, ishte një sfidë në punën tonë.

Për të kapërcyer këtë, u propozua përgatitja e statistikave të ndara sipas gjinisë për pjesën programore (përdoruesit e trajnimeve, shërbimeve, masave etj.) të cilat do të regjistrohen në të gjitha dokumentet strategjike.

6.2 Ndani një shembull të praktikës së mirë ose të keqe.

Forcimi i aspektit gjinor përmes zbatimit të vazhdueshëm të Konceptit të ri për arsimin fillor, përgatitjes së programeve dhe materialeve të reja mësimore, si dhe realizimit të trajnimeve për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesional me qëllim të avancimit të tyre profesional. Në kuadër të këtij procesi, ndërgjegjësimi për barazinë gjinore po rritet vazhdimisht.

6.3 Jepni shembuj të mësimave të nxjerra.

Rëndësia e institucioneve arsimore përmes të gjitha aktiviteteve dhe dokumenteve për ndërgjegjësimin dhe promovimin e parimit të mundësive të barabarta.

7. HAPAT E ARDHSHËM

7.1. Përshkruani shkurt se cili është plani juaj i veprimit për vitin e ardhshëm dhe në çfarë do të kontribuojnë (zbatimi i Strategjisë për Barazinë Gjinore, një dokument tjetër strategjik i OASH-së, etj.)

Në Planin vjetor të punës së Byrosë së Zhvillimit të Arsimit për vitin 2024, i cili është përgatitur në përputhje me Planin Strategjik të Byrosë për vitin 2024-2026 nr.01-129/2 nga 11.1.2024 dhe në përputhje me Strategjinë për Arsimin 2018-2025, si dhe prioritetet dhe synimet strategjike të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për realizim janë paraparë aktivitetet në vijim:

- realizimi i trajnimeve për kuadrin edukativ-arsimor për edukimin dhe arsimin parashkollor për tema që kanë të bëjnë me procesin edukativo-arsimor;
- krijimi i programeve mësimore të reja për klasat e 8-ta dhe të 9-ta dhe trajnimi i kuadrit mësimor për programet e reja;
- krijimi i standardeve kombëtare për kompetencat që duhet të fitojnë nxënësit në përfundim të arsimit të mesëm;
- hartimi i planeve dhe programeve të reja mësimore dhe trajnimi i kuadrit mësimor për të gjitha llojet e arsimit të mesëm;
- analiza e projekteve dhe përgatitja e mendimeve profesionale në fushën e arsimit;
- analiza e teksteve shkollore, literaturës profesionale dhe revistave për fëmijë për arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm;
- zbatimi i projekteve kërkimore-shkencore në fushën e AGjS-së;
- kryerja e vizitave profesionale këshilluese për monitorimin dhe vlerësimin e punës së mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional;
- zhvillimi i vazhdueshëm profesional i kuadrit arsimor në arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm;

- krijimi i koncepteve, akteve nënligjore, udhëzimeve dhe dokumenteve të tjera.
Në të gjitha këto aktivitete do të inkorporohen parimet e mundësive të barabarta, të cilat do të kontribuojnë në ndërgjegjësimin, inkurajimin dhe promovimin e mundësive të barabarta ndërmjet grave dhe burrave.

8. REKOMANDIMET DHE SUGJERIMET PËR SMB-MPPS

8.1. Paraqitni rekomandimet ose iniciativat tuaja në SMB-MPPS në drejtim të përmirësimit të:

a) Funkcionalitetit dhe koordinimit të mekanizmave për barazinë gjinore

Organizimi i takimeve online për koordinatorët dhe zëvendëskoordinatorët e OASH-ve të ndryshme me qëllim shkëmbimin e informacionit dhe përvojave në lidhje me zbatimin e parimeve të mundësive të barabarta.

b) Zbatimit të Strategjisë për Barazinë Gjinore në politikat/programet sektoriale /

Shtojca 1

4. PARIMI I MUNDËSIVE TË BARABARA PËR GRATË DHE BURRAT

Në Byronë e Zhvillimit të Arsimit nga aspekti i barazisë gjinore, nga gjithsej 150 të punësuar, 53 janë burra dhe 97 gra. Gjithashtu, nga gjithsej 21 nëpunës administrativë të punësuar me arsim të lartë, 5 janë burra dhe 16 janë gra, dhe nga gjithsej 129 nëpunës administrativ joudhëheqës të punësuar, 48 janë burra dhe 81 gra, prej të cilëve me arsim të lartë janë 36 burra dhe 69 gra, ndërsa me arsim të mesëm 11 burra dhe 11 gra dhe me arsim fillor 1 burrë dhe 1 grua.

Vendi i punës	Sipëror		I lartë		I mesëm		Fillor		GJITHSEJ		Gjithsej të punësuar në organ
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	
Udhëheqës	5	16							5	16	21
Joudhëheqës	36	69			11	11	1	1	48	81	129
Gjithsej	41	85			11	11	1	1	53	97	150

Ndikimi i pritur në vitin 2024	Ndikimi i pritur në vitin 2025	Ndikimi i pritur në vitin 2026
Zbatimi i kriterëve për mundësi të barabarta për gratë dhe burrat në përputhje me Ligjin për mundësi të barabarta për gratë dhe burrat (barazia gjinore) do të merret parasysh gjatë punësimeve të reja në Byronë e Zhvillimit të Arsimit.	Zbatimi i kriterëve për mundësi të barabarta për gratë dhe burrat në përputhje me Ligjin për mundësi të barabarta për gratë dhe burrat (barazia gjinore) do të merret parasysh gjatë punësimeve të reja në Byronë e Zhvillimit të Arsimit.	Zbatimi i kriterëve për mundësi të barabarta për gratë dhe burrat në përputhje me Ligjin për mundësi të barabarta për gratë dhe burrat (barazia gjinore) do të merret parasysh gjatë punësimeve të reja në Byronë e Zhvillimit të Arsimit.